

STATUTI

I

SHOQERISE TREGTARE “ TIRANA BUS ” sh.p.k

Kapitulli I

EMRI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 - Forma

1.1 Shoqëria “ TIRANA BUS ” Shpk ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “PER TREGTARET E SHOQERITE TREGTARE” dhe te ligjit 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne Tirane sot me date 21.02.2020 shtetesja Liljana Parllaku , e bija e Osmanit dhe Zojes , e datelindjes 07.06.1967 , mbajtese e kartes se identitetit nr.034163085 banuese Lagjia Mihal Grameno nr.212, Njesia Administrative nr.2 Tirane , me vullnetin e saj te lire dhe te plote , ne perputhje me legjislacionin shqiptar vendosi te krijojë Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar ““ TIRANA BUS ” Tirane

1.2 Shoqëria “ TIRANA BUS ” Shpk krijohet me mjetet ne pronesi te themeluesit te saj Znj.Liljana Parllaku

1.3 Shoqëria “ TIRANA BUS ” shpk është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me ortak të vetëm, dhe aktiviteti i saj rregullohet me anë të këtij Statuti.

1.4 Shoqëria vepron sipas ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”

1.5 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 – Emri

2.1 Emri i Shoqërisë është: “ TIRANA BUS ” Shpk

Neni 3 – Objekti

3.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

Transport urban,interurban dhe nderkombetar per pasagjere dhe per mallra,tregti , import eksport mallra te ndryshem, automjete, pjese kembimi ,etj, agjensi transporti udhetaresh brenda vendit dhe shitje te biletave .Sherbim servisi te automjeteve te transportit (autovetura,autobuze,kamione etj),sherbim servisi te automjeteve te ndertimit,parkim automjetesh, lavazh automjetesh, autoshkolle

Shoqëria mund te ushtroje gjithashtu edhe aktivitete te tjera ndihmese ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, te konsideruara me perfitim si dhe te dobishme per arrijten e objektivave te saj kryesore. Shoqëria ka te drejte te bashkepusoje me persona fizike, juridike, me çdo shoqëri tjetër, brenda dhe jashte vendit.

3.2 Shoqëria mund te bashkepusoje dhe/ose te marre direkt ose indirekt interesa , ne shoqëri ,firma,agjensi dhe ndermarrje te tjera ,te cilat mund te kene dhe qllime te tjera aktiviteti Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arrijten e



3.3 Gjithashtu, per te realizuar objektin dhe qellimet e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurise se luajtshme e te paluajtshme, si edhe cdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhenes apo dorezenes, qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj.

Neni 4 - Selia

4.1 Selia zyrtare e shoqerise ndodhet ne Rruga Abdi Toptani nr.3 Tirane Ortaku i vetem mund te vendose te transferoje seline e Shoqerise ne nje vend tjetet, apo mund te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise kudo, brenda apo jashte Republikes se Shqiperise.

Neni 5 - Kohezgjatja

- 5.1 Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise eshte e pa kufizuar.
- 5.2. Shoqeria mund te perfundoje apo vihet ne likuidim perpara ketij afati me vendim te ortakut te vetem.

Neni 6 - Pergjegjesite

- 6.1. Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e marra per qellime qe nuk perputhen me ato te percaktuara nga Statuti.
- 6.2. Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e marra nga ortaku ne emrin e tij personal ndaj personave te trete.

Kapitulli II

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7 - Kapitali


- 7.1. Kapitali themeltar i shoqerise "**TIRANA BUS** " sh.p.k. Perbehet nga kontributi fillestar i themeluesit te shoqerise ne vleren 100.000 leke .Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike

Neni 8 - Kuotat e kapitalit dhe zoterimi i tyre

- 8.1. Kapitali eshte i perbere nga 1 (nje) kuote kapitali, te gjitha te nenshkuara dhe te paguara,
- 8.2. Kuotat e kapitalit te Shoqerise "**TIRANA BUS** " sh.p.k. zoterohen 100% nga ortaku i vetem znj.Liljana Parllaku

Neni 9 - Zmadhimi i kapitalit

- 9.1. Ortaku i vetem mund te rrise pa kufi kapitalin e shoqerise.
- 9.2. Administratoret njoftojne per regjistrim, prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, vendimin per zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe ne faqen e internetit te shoqerise.



- 9.3. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 9.4. Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme vendos edhe për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë që me këto fitime të zmadhojë kapitalin e regjistruar, të rrisi rezervat statutore ose të shpërndajë dividend.
- 9.5. Në asnjë rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë pa mbuluar më parë humbjet e rezultuara në pasqyrat financiare.
- 9.6. Në përputhje me nenin 77 të ligjit 9901 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", përpara se të vendoset për shpërndarje dividendi, administratori lëshon çertifikatë të aftësisë paguese. Kjo çertifikatë lëshohet vetëm në se pas pagimit të dividendit, aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brënda 12 muajve në vazhdim.

Neni 10 – Krijimi i rezervave

- 10.1 Mbas miratimit të pasqyrave financiare, asambleja krijon rezerva statutore. Rezerva statutore duhet të jetë për çdo vit jo më pak se 10% e fitimit vjetor. Kur këto rezerva të kapin shumën sa 10% të kapitalit themeltar, asambleja e ortakëve mund të mos krijojë më rezerva.

Neni 11 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 11.1. Ortaku i vetëm mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 11.2. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 12 – Transferimi i kuotave të kapitalit

- 12.1. Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen lirisht të tretëve, tërësisht ose pjesërisht.

Neni 13 - Pasojat e kalimit të kuotave

- 13.1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë, për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Kapitulli III

ORTAKU I VETËM, ADMINISTRIMI, KONTROLLI

Neni 14 – Të drejtat dhe detyrimet

- 14.1. Ortaku i vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë lidhur me çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;



- ç) emërimin, shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15 - Procesverbalet

- 15.1. Të gjitha vendimet e ortaku të vetëm regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të shoqërisë.

Neni 16 - Hetimet e posaçme

- 16.1. Ortaku i vetëm mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm, për parregullsitë përgjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 91 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 17 - Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

- 17.1. Ortaku i vetëm ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 92 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 18 – Administrimi

18.1. Shoqëria administrohet nga administratorët. Ortaku i vetëm emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje. Administrator i Shoqërisë "TIRANA BUS" sh.p.k. për një periudhë 5-vjeçare nga data e miratimit të këtij statuti është ortaku i saj i vetëm Liljana Parllaku

18.2. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm;
- b) përfaqësojnë Shoqërinë;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



18.3. Ortaku i vetëm mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.

Neni 19 - Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

19.1. Administratorët detyrohen të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi. Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale.

Kapitulli IV

SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 20 - Shpërndarja e fitimeve

20.1. Ortaku i vetëm ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Kapitulli V

PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 21 - Shkaqet e prishjes së shoqërisë

21.1. Shoqëria priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk kryen veprimtari tregtare për dy vjet;
- d) me vendim të gjykatës;

Ky statut hartohet në 3 kopje në gjuhen shqipe.

Lexuar, nënshkruar

ORTAKU I VETËM

Liljana Parllaku



Dt. 01/03/2020